

facebook   

Nëse dëshiron të informohesh i pari...  Like

E Martë, 27 Mars 2012

Impresum Rss Feed

BALLINA POLITIKA **BUKURESTI** EKONOMIA BOTA & RAJONI SPORT ROZE ARTE OPINIONE SHKURTESHQP LOJERA

15 BURSA PËR DOKTORATURË NË AUSTRI



Nga Express 26 Mars 2012 19:19

Mashkulla e titullit: A A A

Bashkëfinancimi i projektit "Higher-KOS" në mes të Agjencionit Austriak për Zhvillim dhe të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, do të sjellë më shumë 15 bursa studiimi për studentët të cilës studiojnë në doktoratë dhe postdoktoratë. Një projekt të tillë e kanë vlerësuar lart ministri i Arsimit, Ramë Buja, si dhe rektorët Mujë Rugova i UP-së dhe Mazlum Baralju i UPZ-së, duke e quajtur si një filim të mirë për zhvillimin e shkencës, si dhe e kanë falënderuar Austriën për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë Kosovës në të gjitha fushat, por me theks të veçantë në atë të arsimit, e cila edhe në kushte të vështira të ekzistimit arsimor të parafutës, ajo i ka rihur diplomate e Kosovës. Kështu u tha në një konferencë për media me temën "Higher-KOS- Promovimi i Zhvillimit Institucional në Arsimin e Lartë dhe në Shkencë në Kosovë".

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ramë Buja, duke folur për projektin në fjalë, ka thënë se është një projekt shumë i rëndësishëm për zhvillimin e shkencës në Republikën e Kosovës. Ai nuk ka hezuar ta përsërisë thënien se Ministria e Arsimit e ka shpallur jo vet, por mandat cilësor, por ka shtuar se nuk do të thotë që pas këtij mandati duhet të përfundojë cilësia në arsim.

"Njerëzit që do të përfitojnë nga kjo dhënie, do të jenë kryesisht ata që do studiojnë në PhD ose në doktoratë dhe kjo shumë ka vlerë dhe rëndësi për ne. Kryesisht kjo gëshje orientohet në tri pika ose tri segmente kryesore që është cilësia në edukim, është gëshja e promovimit të hulumtimeve shkencore dhe menaxhimi i cilësia në këto segmente dhe kjo për ne është shumë e rëndësishme, meqë ju e dini se edhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e ka shpallur, jo vet, por mandat cilësor kështu mandat, pa pretenduar që të përfundojë këtu cilësia dhe më sëkanë çka të shtohet, por duke dëshiruar që të jetë gjumë në këtë gëshje", ka thënë ai.

Ndërsa, Rektori i Universitetit të Prishtinës, Mujë Rugova, duke e falënderuar shtetin e Austriës, ka thënë se ky shtet ka qenë ndër të parët që para luftës ka rihur diplomat, kur arsimi në Kosovë po mbahej nëpër shtëpitë private.

Ai ka shtuar se ky projekt ka për qëllim që studentët që janë në studime të doktoratës dhe postdoktoratës ta ngritin nivelin e djes dhe më pas të kthehen në universitetet e vendit.

"Ky projekt ka për qëllim që studentët tanë që janë në studime të doktoratës dhe postdoktoratës ta ngritin një nivel më të lartë të cilësia së veçelës, të kualifikimit të tyre dhe të arrijnë shkencore në fushën e tyre dhe pastaj ti kthehen universiteteve shqiptare këtu në Kosovë, qofshin publike, qofshin edhe atyre private", ka thënë ai.

Ai ka shtuar se shteti i Austriës i ka ofruar Universitetit të Prishtinës që të konkurrojë në projekte të cilat kanë për bazë mjetet e akredituara nga Austria me zero kamata, të cilat mjete do të mund të përdoren për blerjen e mjeteve për zhvillimin e shkencës.

Kurse, rektori i Universitetit të Prizrenit, Mazlum Baralju, ka thënë se për UPZ-në, për Kosovën dhe për të gjithë, ky projekt ka hapur një dritare tjetër, e cila do të ndihmojë në avancimin e vlerave dhe të cilësia në arsimin e lartë etj.

"Për ne, Universitetin e Prizrenit, për të gjithë Kosovën dhe institucionet e saj mendoj se ky projekt është një dritare tjetër e hapur, e cila do të ndihmojë avancimin e mëtejshëm në ngritjen e vlerave dhe cilësia së arsimit të lartë, ngritjen e ekspertëve, forcimin e universitetit tonë", ka thënë ai.

Ai ka shtuar se Universiteti i Prizrenit ka më tepër nevojë për këtë frymë të projekteve dhe të kuadrove të reja.

Ndërkaq, Christian Geosist nga Agjencioni Austriak për Zhvillim, është shprehur i kënaqur që në këtë projekt po merr pjesë edhe MASHT, duke e konsideruar si shumë të rëndësishëm pjesëmarrjen e saj.

"Për herë të parë Ministria e Arsimit ka financuar si bashkë financues dhe kjo është shumë e rëndësishme, ne e konsiderojmë kështu dhe mendojmë se rezultatet do të jenë të prekshme", ka thënë ai.

Ai ka shtuar se bashkëpunimi i Austriës me Universitetin e Prishtinës ka filluar qysh në vitet e 90-a, dhe është ndër shumë mirë që parafutës e tij e caktën një gjë të tillë.

Ndërkaq, ky projekt do të zgjasë tri vjet, deri në dhjetor të vitit 2014, dhe do të financohet nga Agjencioni Austriak për Zhvillim në bashkëfinancim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës dhe implementohet nga konzorciumi i tri institucioneve partnere: WUS-Austria (World University Service), ZSI (Center for Social Innovation) dhe OeAD (Austrian Exchange Service).

Projekt Higher-KOS, me përkatshjen që do të ofrojë institucioneve arsimore të Kosovës, duke ofruar rreth 15 bursa, afro 10 granta për hulumtime shkencore, partneritete programore me universitete austriake, po edhe me ato në rajon, si dhe me shumë veprimtari të tjera, do të kontribuojë në funksionimin sa më të mirë të sistemit të arsimit të lartë në Kosovë, po edhe të atij shkencor në përputhje me vlerat, praktikat dhe standardet evropiane. /cosovapress/

0 0 0

Recommend Tweet

Shpërndaje:  Print Email

KOMENTET (0)

Komento

Ndalohej përdorimi i gjuhës denigruese dhe fjalëve ofenduese ndaj individëve dhe ndaj grupeve specifike, si dhe komentimet që shpesh të bëjnë me temën e artikullit. Moderatorët mbajnë të drejtën e fshirjes së komentave që thyejnë rregullat e komunikimit.

Emri: Komenti:

Email:

Ku i Vërdhëdoqja:

3228 Kod:



TË FUNDET

- 12:45 Merket: Qeveria nuk është e rrezikuar
- 13:43 Krijohen kushte modeste për gazetarët
- 13:31 Konkurs për Qezalin, Zogun e Prishtinës
- 13:39 Dyfishohet numri i tentim-vetëvrasjeve në Greqi
- 13:14 Norvegjezët vazhdojnë mbështetjen për Mitrovicën
- 11:29 Bashkë për kulturën e trashëgiminë
- 11:26 Tadiq nuk do të ketë takim me Thaçin
- 11:21 Veç ma keq
- 11:12 Rihanna-s i pëlqen të rri zveshur
- 10:59 S'dëshiron të kërkohet në Google

